

VENDIM
Nr. 302, datë 11.5.2022

**PËR POLITIKAT KOMBËTARE PËR RIORGANIZIMIN E SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT, TRAJTIMIT DHE PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i riorganizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura është të përmirësojë sigurimin e furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve.

2. Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshme përmes mbulimit të plotë të kostos.

3. Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimet ofron qasje universale, që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore/evropiane, sipas parimit “ndotësi pagan”.

4. Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizimet të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane.

5. Ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët të sigurohet me një çmim të përballueshëm.

6. Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparenca në politikat e ujit.

7. Për të realizuar krijimin e një sektori të furnizimit me ujë sipas standardeve evropiane vlerësohet krijimi i subjekteve me kompetenca të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas hartës së shoqërive UK të reja, të përcaktuar në lidhjen nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

**II. RIORGANIZIMI I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT,
TRAJTIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

1. Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.

2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas formatit tip të përcaktuar në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim “SKP”), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe legjislacionin

në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

4. Riorganizimi i SKP-ve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, fillon në vitin 2022 dhe përfundon sipas një programi të bashkërenduar ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

5. Marrëveshja hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut/prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

6. Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin për të krijuar shoqërinë aksionare me aksionar edhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, ministria zotëron jo më pak se 51 (pesëdhjetë e një) % të aksioneve me të drejta vote. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë lidhur marrëveshje për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të tyre, zotërojnë bashkërisht jo më shumë se 49 (dyzet e nëntë) % të aksioneve me të drejta vote të SKP-së së krijuar rishtazi, në përpjesëtim me numrin total të abonentëve aktivë, që kanë shoqëritë aksionare ekzistuese në pronësi të tyre në momentin e nënshkrimit dhe të hyrjes në fuqi të marrëveshjes për krijimin e SKP-së.

7. Kapitali themeltar për secilën nga SKP-të e krijuara është jo më i vogël se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë. Shlyerja e vlerës së kapitalit të nënshkruar të bëhet sipas marrëveshjes të nënshkruar nga secila prej palëve, në përputhje me statutin, legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe përqindjen e aksioneve që do të zotërohen prej tyre, sipas parashikimit të dhënë në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Pas themelimit të SKP-ve të krijuara nga riorganizimi, vijohet me transferimin e plotë të veprimtarisë, që aktualisht ushtrohet nga shoqëri publike të ujësjellës-kanalizimeve (transferuesit) tek SKP-të e krijuara (marrësit e transferimit). Transferimi i veprimtarisë do të bazohet mbi një kontratë (akt transferimi) të noterizuar, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cili do të nënshkruhet rregullisht ndërmjet palëve (transferuesve dhe marrësit të transferimit) dhe do të regjistrohet në pasqyrat financiare të shoqërive.

9. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve, që do të zotërohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të kryhet duke njohur investimet në proces, të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale të ardhshme që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në gjithsecilën prej këtyre shoqërive ose nëpërmjet shuarjes me kompensim të detyrimeve që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ndaj institucioneve të tjera qendrore buxhetore dhe jobuxhetore.

10. Shlyerja e kontributeve nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën mund të realizohet edhe nëpërmjet të drejtave të vlerësueshme në para, të tilla si kompensimi i vlerës së detyrimeve që shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-së. Aksionarët do të nënshkruajnë kontratë rritjeje kapitali, që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen e të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas marrëveshjes së krijimit të SKP-së.

11. SKP-të e krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të parashikuara në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, respektojnë dhe zbatojnë kontratat e shërbimit të lidhura para krijimit të tyre, detyrimet kontraktore që burojnë nga marrëveshjet e lidhura nga Këshilli i Ministrave, ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe detyrimet kontraktore nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet ish-njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve financiare ndërkombëtare ose shoqërive kontraktuese përkatëse.

12. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë u akordon SKP-ve, të krijuara në kuadër të riorganizimit me marrëveshje të subjekteve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, fondet e planifikuara për investime nga buxheti i shtetit apo nga institucionet financiare ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e dokumenteve strategjike sektoriale në fuqi.

13. SKP-të e krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, të parashikuara në pikat 1 e 2, të këtij vendimi, brenda 3 (tre) muajve nga shprehja e ligjshmërisë nga prefekti i qarkut dhe përfundimi i procesit të plotë të transferimit, paraqesin kërkesë pranë Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për pajisjen me licencë, sipas kategorisë përkatëse të shërbimit të ofruar dhe rishikimin e tarifave ekzistuese.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, me vullnet të lirë, lidhin marrëveshje bashkëpunimi me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas pikës 1, të këtij vendimi, marrin masa për transferimin e plotë të veprimtarisë ekonomike të shoqërive aksionare ekzistuese të SKP-ja e krijuar me marrëveshje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe planin kombëtar të hartuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve për riorganizimin e shoqërive ujësjellës-kanalizime. Transferimi i veprimtarisë së parashikuar në këtë pikë bëhet me akt noterial, sipas formatit të parashikuar në lidhjen nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i cili, pas nënshkrimit nga shoqëritë përkatëse, bëhet pjesë e pasqyrave financiare dhe mbahet nga pala që i ka kaluar transferimi.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përfshirë shpenzimet për transferimin e plotë të veprimtarisë të SKP-ja e krijuar rishtazi dhe shpenzimet për themelimin e SKP-ve përballohen nga buxheti i shtetit.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Ujit, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LIDHJA NR. 1

MARRËVESHJA TË PËR KRIJIMIN E SUBJEKTEVE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE (SKP-UK)

Marrëveshje për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës-kanalizimeve

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë _____ ndërmjet

Bashkisë _____, përfaqësuar nga kryetari i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga kryetari i Bashkisë z./znj. _____

Bashkisë _____, përfaqësuar nga kryetari i Bashkisë z./znj. _____

dhe

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (në vijim “MIE”), përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (në vijim “AKUM”), sipas urdhrit nr. _____, datë _____, të ministrit,

këtej e tutje, referuar të gjitha si “palët”.

- Duke pasur parasysh reformën e ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve;

- Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e trajtimit e ujërave të ndotura urbane;

- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve _____, _____ dhe _____ vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin e administrimit të aseteve të saj, shëndoshjen e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e tyre të shërbimit;

- Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave që autorizon MIE-në për hyrjen në një marrëveshje specifike me bashkitë A, B dhe C për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të bashkive A, B dhe C;

- Në mbështetje të vendimeve të këshillave bashkiakë të A, B dhe C, që autorizojnë kryetarët e bashkive A, B dhe C të hyjnë në një marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, që mbulojnë territorin administrativ të bashkive A, B dhe C;

Palët bien dakord të hyjnë në një marrëveshje me kushtet dhe termat e mëposhtëm:

Neni 1 **Baza ligjore**

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:

a) dispozitat e pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar;

b) ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;

c) ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ç) VKM-në nr.____, datë _____.____.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Neni 2 **Qëllimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës-kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, që mbulojnë territorin administrativ të bashkive A, B dhe C, të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM-i.

Neni 3 **Forma dhe emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta**

1. Palët bien dakord që subjekti i kompetencave të përbashkëta të ujësjellës-kanalizimeve do të jetë një shoqëri aksionare e krijuar SKP-UK, tek e cila do të transferohet tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, të cilat aktualisht janë në pronësi të bashkive A, B dhe C.

2. Emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta i krijuar sipas kësaj marrëveshjeje do të jetë _____.

3. Shoqëria aksionare e krijuar sipas kësaj marrëveshjeje do të administrohet me dy nivele administrimi. Organet drejtuese të shoqërisë do të krijohen dhe kompozohen sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

4. Shoqëria do të ketë si statut të saj statutin tip të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4 **Objekti i SKPUK-së**

1. Objekti i SKPUK-së është kryerja e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, që mbulojnë territoret administrative të bashkive A, B dhe C, në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë.

2. Shoqëria e re e krijuar mund të ngarkohet me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të bashkive palë në këtë marrëveshje, nëse kjo kërkohet prej tyre.

Neni 5

Afati i SKPUK-së

Palët bien dakord që SKPUK-ja i krijuar sipas kësaj marrëveshjeje të krijohet për një periudhë të pacaktuar.

Neni 6

Kontributi i palëve

1. Kapitali fillestar për secilën prej shoqërive të reja SKP-UK që do të themelohen do të jetë në masën 10.000.000 lekë. Në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK, MIE do të likuideojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.

2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionarëve në shoqërinë e re ujësjellës-kanalizime (SKPUK) e bashkitë A, B dhe C, në pronësi të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, është përlllogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktivë që këto shoqëri kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK-së, vlera totale e të cilave të përbëjë 49% të aksioneve të shoqërisë së re, dhe përbëhet në përqindje, si vijon: Bashkia A x%, Bashkia B x%, dhe Bashkia C x%.

3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, bashkitë A, B dhe C do të transferojnë te SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK-ve që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.

4. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në gjithsecilën prej shoqërive të reja të ujësjellës-kanalizimeve SKP-UK do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga eksperti kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.

5. Aksionarët do të nënshkruajnë kontratë rritjeje kapitali, që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen e të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas marrëveshjes së krijimit të SKP-së.

6. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces, të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në gjithsecilën prej këtyre shoqërive.

7. Në rastet kur vlera e investimit të parashikuar dhe të marrë tashmë përsipër nga qeveria qendrore dhe të pasqyruar në tavanet buxhetore do të kalojë vlerën nominale të 51% të aksioneve, pasqyrimi i vlerës se tepricës nuk do të ndryshojë masën e pjesëmarrjes në aksionet e shoqërisë së re SKP-UK të Bashkive që do të pranojnë kushtet e riorganizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

8. Gjithashtu, si instrument për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të konsiderohen edhe shuarja me kompensim të vlerës së detyrimeve që shoqëritë UK kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-UK, ndaj

institucioneve qendrore buxhetore dhe jobuxhetore, deri në masën e pagimit të plotë të 51% të aksioneve të shoqërisë së re.

Neni 7

Procedurat e transferimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive UK, me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), do të caktojnë një ekspert të pavarur për të vlerësuar e asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK.

2. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2021.

3. Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga shoqëria SKP do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i drejtorive tatimore.

4. Veprimtaritë e UK në periudhën nga data e bilancit të transferimit deri në datën e transferimit efektiv do të sjellë si pasojë ndryshimin e balancave të transferimit, të cilat do të rregullohen me efekt në tepricën e transferimit që do të njihet. Pasqyrat financiare do të hartohen në datën e transferimit efektiv dhe për këtë mund të përgatitet një raport i posaçëm për të identifikuar diferencat dhe rregullimin e tyre.

5. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës së themelimit të shoqërive të reja SKP-UK, shpenzimet e nevojshme për caktimin e eksperteve, si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë të shoqëritë e reja do të përballohen nga buxheti i shtetit. Vlera e shpenzimeve të mësipërme, si dhe vlera e shpenzimeve fillestare që do t'u akordohet shoqërive të reja ujësjetës-kanalizime SKP-UK, do të përlllogaritet si kontribut në shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të përfutuara nga MIE.

6. Shpenzimet për likuidimin e shoqërive transferuese do të përballohen nga shoqëria e re SKP-UK.

Neni 8

Prishja e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme

1. Asnjë nga palët nuk mund të prishë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa kaluar 10 vjet nga krijimi i SKP-UK-së.

2. Pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përcaktuar në pikë 1, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në çdo kohë, mund të vendosë tërheqjen e njëanshme nga kjo marrëveshje, duke i transferuar aksionet e saj në shoqërinë e krijuar sipas kësaj marrëveshjeje te bashkitë A, B dhe C proporcionalisht me përqindjen e aksioneve të tyre në shoqëri.

3. Nëse një nga bashkitë A, B dhe C kërkon prishjen e njëanshme të kësaj marrëveshjeje mbas kalimit të afatit 10-vjeçar, bashkia duhet të ndërmarrë hapat e kërkuar në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

4. Nëse një nga bashkitë vendos të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas pikës 3, të këtij neni, ajo është e detyruar që për vitin buxhetor pasardhës të mbulojë të gjitha investimet apo detyrimet e tjera financiare përfshirë masat e miratuara në planin e biznesit të shoqërisë së ujësjetës-kanalizimeve.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, palët do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim; në të kundërt, secila nga palët mund t'i drejtohet për zgjidhjen e saj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut apo prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

LIDHJA NR. 2
STATUTI TIP PËR SHOQËRITË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË
PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE (SKP-UK)
LIDHJA NR. 2 - STATUTI TIP I SHOQËRIVE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

STATUT I SHOQËRISË AKSIONARE “_____” SKP- UK

Neni 1
Emërtimi dhe selia

1. Shoqëria aksionare ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me zonën e juridiksionit të bashkisë/bashkive, aksionarë të saj.
2. Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet shoqëria rajonale - UK sh.a.
3. Selia e shoqërisë është në adresën _____ .

Neni 2
Objekti

1. Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkive është:
 - a) shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
 - b) mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
 - c) prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
 - ç) shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
 - d) mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.
2. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3
Kapitali

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000.000 dhe është i ndarë në 100.000 aksione me vlerë normale 100 lekë secili. Kapitali i shoqërisë është nënshkruar dhe paguar tërësisht.
2. Aksionet zotërohen nga aksionarët:
 - Bashkia A në masën x% të kapitalit themeltar;
 - Bashkia B në masën x% të kapitalit themeltar;
 - Bashkia C në masën x% të kapitalit themeltar;
 - Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në masën 51% të kapitalit themeltar.

Neni 4
Aksionet e shoqërisë

1. Aksionet janë të formës nominative dhe pronësia mbi to është e patjetërsueshme.
2. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të titullarit në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë.

Neni 5
Organet e shoqërisë

1. Organet e shoqërisë Shoqëria Rajonale - UK sh.a., janë:
 - Asambleja e Përgjithshme;
 - Këshilli Mbikëqyrës;
 - Administratori.
2. Administratori emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 6
Asambleja e Përgjithshme (AP)

1. Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, janë detyruese për shoqërinë, aksionarët, organet e tjera, si dhe zyrtarët e shoqërisë.

2. Asambleja e Përgjithshme përfaqësohet në mbledhjet e saj nga përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak respektiv të pajisur me autorizim specifik dhe nga përfaqësuesi i AKUM-it, si enti shtetëror i ngarkuar me përfaqësimin e aksionarit MIE-së. Pësha e votës e secilit prej anëtarëve të Asamblesë është në përpjesëtim me përqindjen e aksioneve.

3. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e shoqërisë. Ajo thirret nga kryetari i AP-së, Këshilli Mbikëqyrës, administratori i shoqërisë. Ajo mund të thirret, gjithashtu, nga: eksperti kontabël i autorizuar; nga një mandat mbajtës, i caktuar nga gjykata, me kërkesën e çdo personi të autorizuar për një rast urgjent; me kërkesë të aksionarit të shoqërisë, i cili ka të paktën 5% të aksioneve.

4. Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar.

5. Thirrja e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nëpërmjet lajmërimit që i dërgohet me anë të korrespondencës elektronike, si dhe një njoftimi me letër rekomandë çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme me shpenzimet e shoqërisë.

6. Në njoftimin, që duhet t'i shkojë çdo anëtar të Asamblesë së Përgjithshme apo të njihet prej çdo anëtar, të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së saj, përcaktohen dita, ora dhe vendi ku bëhet mbledhja, natyra e mbledhjes dhe rendi i ditës.

7. Çdo vendim i marrë nga Asambleja e Përgjithshme, që thirret në mënyrë të parregullt, është absolutisht i pavlefshëm. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas procedurës së kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë anëtarët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht nga parregullsia.

Neni 7
Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
 - a) përcakton politikën tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Administratori dhe miratuar paraprakisht nga Këshilli i Mbikëqyrës i shoqërisë, i cili duhet të

përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore;

- b) emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës.
- c) emëron dhe shkarkon likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar
- ç) miraton skemën e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “b” e “c” të kësaj pike;
- d) miraton pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë;
- dh) miraton projekt planin tarifor që propozohet për miratim në Entin Rregullator të Ujit;
- e) miraton shpërndarjen ose jo të fitimeve vjetore;
- ë) vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e Këshillit Mbikëqyrës dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

2. Asambleja e Përgjithshme ka çdo kompetencë tjetër që parashikohet të ushtrojë Asambleja e Përgjithshme në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar dhe në statut.

Neni 8

Kryetari dhe sekretari i Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga përfaqësuesi i AKUM-it në cilësinë e përfaqësuesit të aksionarit MIE.

2. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme asistohet nga një sekretar i emëruar nga AP-ja, i cili është përgjegjës për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve, si dhe për detyrat e tjera asistuese që i ngarkon kryetari i AP-së.

3. Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e AP-së jepen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emrat e drejtuesit e të sekretarit të AP-së, kuorumi i arritur dhe numri i aksioneve me të cilat është votuar, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e AP-së, një përmbledhje e diskutimeve, teksti i vendimeve të kaluara për votim dhe rezultati i votimit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit e AP-së në mbledhje, si dhe nga sekretari.

Neni 9

Rendi i ditës i Asamblesë së Përgjithshme

1. Rendi i ditës i mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme përcaktohet nga personi, i cili bën lajmërimin.

2. Në rast se mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme nuk realizohet, rendi i ditës i mbledhjes së saj nuk mund të ndryshohet në lajmërimin për mbledhjen e dytë.

Neni 10

Kuorumi dhe marrja e vendimeve

1. Kuorumi, në rastin e çështjeve që vendosen me shumicë të zakonshme apo për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, në mënyrë që Asambleja e Përgjithshme të mund të marrë vendime të vlefshme, kërkon që të pranishëm në mbledhje të jenë më shumë se 50% e anëtarëve të saj.

2. Të gjitha vendimet e marra nga AP-ja regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) përcaktimin e politikave tregtare;

- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të regjistruar;
 - d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” e “ç” të kësaj pike;
 - dh) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - e) investimet;
 - ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
 - g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
 - gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
 - h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji për shoqëritë tregtare.
3. Asambleja e Përgjithshme merr vendim me 3/4 (tre të katërtat) e votave të anëtarëve, lidhur me:
- a) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
 - b) ndryshim të Statutit;
 - c) riorganizim të Shoqërisë.
4. Asambleja e Përgjithshme merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

Neni 11

Këshilli Mbikëqyrës (KM)

1. Këshilli Mbikëqyrës është organi që ushtron funksione mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.
2. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se 2 (dy) Këshilla Mbikëqyrës të shoqërive aksionare, që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Këshilli Mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar, i cili thërret mbledhjen e Këshillit dhe drejtojnë diskutimet.
4. Këshilli Mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij dhe i cakton atij dhe pagën, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Në rast mungese të kryetarit, mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës drejtohen nga njëri nga anëtarët e tjerë të këshillit, i cili caktohet me votim nga anëtarët për drejtimin e vetëm asaj mbledhjeje.

Neni 12

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

1. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë individë, të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të thjeshtë votash. Ata duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - të jenë me profesion inxhinierë të fushës, ekonomistë ose juristë;
 - të kenë të paktën eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fusha të njëjta ose të përafërta me objektin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - çdo emërim i bërë në kundërshtim me këtë nen është absolutisht i pavlefshëm.
2. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga të paktën 7 (shtatë) anëtarë, prej të cilëve të paktën 4 (katër) anëtarë propozohen nga aksionari MIE.
3. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, në momentin e emërimit, lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kriteret e qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit Mbikëqyrës në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me planet e biznesit të shoqërisë.

4. Në rastin e vendeve vakante, që krijohen me vdekjen apo dorëheqjen e një apo disa anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, kur numri i anëtarëve të këtij këshilli ka zbritur nën minimumin ligjor, administratorët duhet të thërrasin urgjentisht mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të plotësuar numrin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 13

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës ushtron funksione kontrolli dhe mbikëqyrjeje të veprimtarisë së shoqërisë.

2. Këshilli Mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrole që ai i çmon të përshtatshme dhe të njihet me dokumentacionin që e gjykon të nevojshëm për përmbushjen e detyrës së tij.

3. Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;

ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;

d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

dh) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;

e) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit. Raporti i këshillit, përmendur në shkronjën "e", të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;

ë) të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;

f) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;

g) të gjykojë paraprakisht planin e biznesit të shoqërisë, të paraqitur nga administratori. Ky dokument duhet të miratohet e të nënshkruhet nga të gjithë e anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës për t'iu paraqitur AKUM-it për miratim. Pasi AKUM-i ka miratuar planin e biznesit të shoqërisë Këshilli Mbikëqyrës ja paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme.

gj) Të miratojë planin e investimeve kapitale dhe buxhetin vjetor të shoqërisë dhe ta dërgojë për miratim në AKUM.

4. Për çdo çështje tjetër që në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

Mbledhja dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli Mbikëqyrës mbledhet jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetarit.

2. Kryetari duhet të thërrasë mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur administratori ose 2 (dy) prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës i paraqesin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

3. Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët kërkues mund të thërrasin Këshillin e Mbikëqyrës duke i përcaktuar rendin e ditës.

4. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tri) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronike.

5. Çdo thirrje për mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës duhet të përmbajë çështjet kryesore të rendit të ditës. Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës zhvillohet në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrjen e bërë për këtë qëllim.

6. Këshilli i Mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtarët e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.

7. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës pasqyrohen në procesverbalet e mbajtura gjatë mbledhjes nga sekretari i Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës duhet të nënshkruhen nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari dhe sekretari.

Neni 15

Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës përfundon në rastet e mëposhtme:
 - Me mbarimin e mandatit të administratorit.
 - Me konstatimin e atyre rrethanave, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tyre, siç mund të jenë kur:
 - a) anëtari vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
 - b) anëtari humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
 - c) plotësohet mosha për pensionin e plotë të pleqërisë;
 - ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
 - d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

Neni 16

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme, sipas dispozitave përkatëse ligjore apo nënligjore dhe mbulohet nga shoqëria.

2. Shoqëria njih, gjithashtu, dhe shpenzimet e bëra nga anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës, kur këta të fundit dërgohen me shërbim nga vetë Këshilli i Mbikëqyrës për probleme të shoqërisë.

Neni 17

Administratori i shoqërisë

1. Administratori i shoqërisë është individ, i cili zgjidhet si i tillë për shkak të funksionit në shoqëri; në të kundërt, emërimi i tij është i pavlefshëm. Ai kryen administrimin e përditshëm të shoqërisë. Për t'u zgjedhur administrator, personi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë "Master shkencor", në shkencat inxhinierike, ekonomike, juridike apo në fushën e mbikëqyrjes së biznesit, sipas profilit që do të emërohet.

b) Të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe

i certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

c) Të ketë eksperiencë pune si drejtues apo administrator në sektorin publik apo privat, si dhe rezultate pozitive të punës, të vërtetuar me referenca nga punëdhënësit e mëparshëm.

ç) Çdo emërim i bërë në kundërshtim me dispozitën e mësipërme është absolutisht i pavlefshëm.

d) Një person nuk mund të emërohet administrator në më shumë se një shoqëri.

dh) Anëtari e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të caktohet si administrator.

2. Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave ndërmjet Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar.

3. Paga e administratorit caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në aktin e emërimit të tij. Asambleja e Përgjithshme propozon shtim të pagës apo shpërblime për administratorin, sipas kriterëve të performancës në kontratën e punës së lidhur ndërmjet tij dhe administratorit.

4. Administratori ekzekutiv ka këto kompetenca:

a) menaxhon dhe është përgjegjës për aktivitetin e shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave e të planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;

b) harton planet e biznesit të shoqërisë dhe i paraqet në Këshillin Mbikëqyrës;

c) harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë, e cila miratohet nga Këshilli i Mbikëqyrës. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtor/departament teknik dhe një drejtor/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (drejtori i përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti;

ç) i paraqet Këshillit Mbikëqyrës një raport një herë në muaj për ecurinë e shoqërisë. Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, administratori duhet t'i paraqesë Këshillit Mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli;

d) përfaqëson dhe vepron në emër të shoqërisë në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së saj;

dh) paraqet çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme raportin e veprimtarisë së shoqërisë.

e) raporton përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;

ë) lidh kontrata në emër të shoqërisë pas dhënies së mendimit edhe të dy drejtorëve të tjerë;

e) siguron bashkëpunimin me institucionet publike dhe personat juridikë vendas apo të huaj në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë;

f) nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshëm të detyrueshëm për menaxhimin administrativ e financiar të shoqërisë;

g) organizon e bashkërendon punën ndërmjet sektorëve në përbërje funksionale të shoqërisë;

gj) krijon një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

h) kryen regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe ligjeve të tjera në fuqi;

i) i paraqet propozime dhe sugjerime Këshillit Mbikëqyrës, në të mirë dhe interes të veprimtarisë së shoqërisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet;

j) siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës;

k) drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Mbikëqyrës.

Neni 18

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit teknik

1. Drejtori teknik zgjidhet nga administratori (drejtori i përgjithshëm) sipas kriterëve minimale:

a) të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master shkencor”, në shkencat inxhinierike, në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme;

b) të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet;

c) në rastet kur operatori ushtron veprimtari për përpunimin e ujërave për konsum publik apo për përpunimin e ujërave të ndotura, duhet të ketë edhe një drejtues të dytë teknik, të kualifikuar me diplomë universitare në degët inxhinieri hidroteknike, mjedisi, ndërtimi, biokimike, mekanike apo disiplina të ngjashme;

ç) të zotërojë certifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve-trajtimin e ujërave të ndotura. Në rast se në momentin e emërimit të tij nuk ka përfunduar ende procesi i trajnimit dhe certifikimit të stafit menaxherial dhe operacional të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, subjekti të paraqesë vërtetim nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën për pamundësinë objektive për pajisjen me këtë certifikatë. Në çdo rast, administratori paraqet certifikatën sapo certifikimi të jetë bërë i mundur. Konstatimi i mospajisjes me certifikatën përkatëse të kualifikimit përbën shkak për shkarkimin e tij.

2. Drejtori teknik ka këto kompetenca:

a) bën studimin dhe hartimin e projekteve të nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve të veçantë ose zonave të banuara;

b) bën përditësimin e rrjetit të furnizimit me ujë e të kanalizimeve të ujërave të ndotura;

c) është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kontrollin e rrjetit shpërndarës;

ç) administron dhe mirëmban gjithë rrjetin e tubacioneve, kolektorët kryesorë, pusetat e shkarkimit të ujërave të ndotura dhe pajisjet që shërbejnë për largimin e ujërave të ndotura që vijnë kryesisht nga banesat (ujëra të ndotura dhe industriale);

d) është përgjegjës për sigurimin e furnizimit me ujë të pijshëm sasior dhe cilësor në zonën e shërbimit sipas standardeve në fuqi dhe garantimin e një sistemi teknikisht të përshtatshëm për furnizimin me ujë që nga burimet deri tek konsumatori;

dh) garanton largimin efikas të ujërave të ndotura me anë të një sistemi të përshtatshëm të rrjetit të kanalizimeve dhe trajtimin e tij në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura;

e) çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me Administratorin.

Neni 19

Kriteret e përzgjedhjes dhe kompetencat e drejtorit tregtar

1. Drejtori tregtar zgjidhet nga administratori (drejtori i përgjithshëm), sipas kriterëve minimale:

a) të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë “Master shkencor”, në shkencat ekonomike, në degët financë/administrim biznesi;

b) të zotërojë certifikata përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë.

2. Drejtori tregtar ka këto kompetenca:

a) siguron mbarëvajtjen dhe zbatimin e procedurave ligjore për të gjithë veprimtarinë ekonomike-financiare të shoqërisë;

b) siguron zbatimin e praktikave e të procedurave ligjore dhe nënligjore të cilat mbrojnë asetet e shoqërisë dhe administron burimet financiare të saj;

c) harton plan-buxhetin për vitin pasardhës dhe planet financiare strategjike për shoqërinë, të cilat i paraqet për miratim pranë administratorit ekzekutiv;

ç) është përgjegjës dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara, si dhe raportin e administrimit, dokumente, të cilat ia paraqet për miratim paraprak administratorit ekzekutiv. Administratori ekzekutiv i paraqet Këshillit Mbikëqyrës për miratim të gjitha pasqyrat financiare vjetore, raportin e administrimit, si dhe propozimet për caktimin e fitimit;

d) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

dh) ushtron kontrole periodike mbi veprimtarinë ekonomike-financiare të ndjekur nga specialistët përkatës. Garanton ruajtjen e standardeve të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbatimin e standardeve të kontrollit financiar të specifikuara nga ministria përgjegjëse për financat;

e) siguron zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

ë) siguron zbatimin e sistemit financiar dhe të faturim/arkëtimit të shoqërisë;

f) çdo detyrë të caktuar në kontratën e punës me administratorin.

Neni 20

Detyrimi i besnikërisë

1. Përveç sa parashikohet në dispozitat e këtij statuti, administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre, të përcaktuara në ligj ose në statut, në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë;

b) të ushtrjnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut, vetëm për arritjen e qëllimeve, të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojnë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe të mënjanojnë rastet e konfliktit, të pranishme apo të mundshme, të interesave personale me ato të shoqërisë;

d) të ushtrjnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim gjatë kryerjes së detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve kur veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit e vlerësimit të mjaftueshëm të informacioneve dhe lidhet, në mënyrë të arsyeshme, me qëllimet e shoqërisë tregtare.

3. Administratorët, që veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit, të përmendura në pikat 1 e 2, të këtij neni, janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Neni 21

Shkarkimi i administratorit

1. Këshilli Mbikëqyrës mund të shkarkojë administratorin me shumicë të thjeshtë votash në rast të konstatimit të mospërbushjes së objektivave të kontratës ndërmjet palëve.

2. Këshilli Mbikëqyrës duhet të vendosë shkarkimin e administratorit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga një institucion shtetëror për shkarkimin e tij, si rezultat i një detyrimi ligjor/zyrtar.

3. Kur administratori ka munguar për më shumë se 6 muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e drejtorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe.

Neni 22

Përfundimi i mandatit të administratorit

Mandati i administratorit të shoqërisë përfundon me konstatimin e atyre rrethanave, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të mandatit të tij.

Neni 23

Ekspertët kontabël të autorizuar

Kontrolli i shoqërisë ushtrohet nga ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme dhe kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 24

Ushtrimi kontabël

Ushtrimi kontabël fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 25

Inventari – llogaritë vjetore

1. Mbajtja e kontabilitetit dhe paraqitja e pasqyrave financiare vjetore bëhet në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar.

2. Në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, shoqëria i harton pasqyrat financiare vjetore në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

3. Administratori përgatit, në datën e pasqyrave financiare, raportin e administrimit për gjendjen dhe performancën e shoqërisë gjatë ushtrimit kontabël.

Neni 26

Rezultati i ushtrimit dhe përcaktimi i fitimit

1. Fitimi i tatueshëm përcaktohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

2. Nga fitimi pas tatimit, i realizuar gjatë vitit financiar paraardhës, duke zbritur shpenzimet, shoqëria duhet të kalojë në rezervën ligjore, të paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

3. Fitimet e akumuluar nga shoqëria nuk do të shpërndahen për aksionarët pa marrë miratimin e MIE-së. Pas arritjes së rezervës 10 për qind, nëse MIE-ja e miraton, vlera e të cilave e kalon nevojën për investime dhe zhvillimin e shoqërisë, do t'i kalojnë dhe do të përdoren nga bashkitë aksionare. Fitimet e akumuluar brenda këtij kufiri do të përdoren nga shoqëria sipas nevojave të saj për investime kapitale.

Neni 27

Procedura e bashkimit të shoqërisë me operatorë të tjerë

1. Shoqëria aksionare mund të bashkohet me operatorë të tjerë vetëm në rastet kur nga ana e shoqërive të plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë licencuar nga Enti Rregullator i Ujit;
- b) të ketë vlerësuar dhe përditësuar inventarin e aseteve e të likuiditeteve të tyre;

c) të jetë miratuar me vendim përkatës të aksionarëve.

Neni 28

Likuidimi i shoqërisë

Likuidimi i shoqërisë të bëhet sipas mënyrës dhe formës të përcaktuar me ligj.

Neni 29

Dispozita të kalimtare

Për sa nuk është parashikuar në statut, rregullimi i modaliteteve të tjera që lidhen me funksionimin e shoqërisë të bëhet sipas dispozitave të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

LIDHJA NR. 3

DRAFTAKTI NOTERIAL TIP PËR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT PËR TRANSFERIM AKTIVITETI NGA SHOQËRITË AKTUALE UK TEK SHOQËRITË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE (SKP-UK)

KONTRATË

(MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI PËR TRANSFERIM AKTIVITETI)

Sot, më datë ____ . ____ . 202__ (dy mijë e njëzet e ____) në dhomën e noterisë _____, paradite para meje noteres së kësaj dhome, të quajturës _____, me seli në rrugën _____, Tiranë, u paraqitën personalisht palët kontraktuese:

SHOQËRIA SKP-UK e regjistruar me NIPT _____, përfaqësuar nga administratori z./znj. _____, i/e datëlindjes _____, lindur dhe banues në _____, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, i/e identifikuar me kartë identiteti _____.

SHOQËRIA _____ e regjistruar me NIPT _____, përfaqësuar nga administratori z./znj. _____, i/e datëlindjes _____, lindur dhe banues në _____, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, i/e identifikuar me kartë identiteti _____.

Baza ligjore: ligji nr. 121/2013, “Kodi Civil i RSH”, pjesa V, “Kontratat”, si dhe ligji nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, udhëzimi nr. 6, datë 30.1.2015, i ministrit të Financave, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar.

OBJEKTI I KONTRATËS

Shoqëria _____ ushtron aktivitet në fushën e “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e tyre etj.”, sipas ekstraktit QKB bashkëlidhur.

Për realizimin e aktivitetit, shoqëria ka në pronësi të saj aktive prona të luajtshme e të paluajtshme, troje, terrene, ndërtesa, impiante, sisteme, makineri, pajisje, automjete, inventarë, si dhe të drejta, të krijuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve të saj, të cilat janë pasqyruar në bilancin e aktivitetit.

Sipas bilancit të aktivitetit, shoqëria _____, gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe krijimit të elementeve pasurore, ka krijuar edhe detyrime të pagueshme ndaj palëve të treta, hua bankare, detyrime ndaj furnitorëve dhe individëve etj.

Aktiviteti “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e tyre etj.”, në tërësi nuk do të ushtrohet më nga shoqëria _____, por, me marrëveshje, këto aktivitete, përfshirë aktivitetet dhe detyrimet do t’i kalojnë shoqërisë SKP dhe këto aktivitete do të vijojnë të ushtrohen nga kjo shoqëri.

DETYRIMET E PALËVE

Shoqëria _____ merr përsipër të transferojë aktivitetin, pronësinë e aktiveve, si dhe detyrimet, brenda datës _____. Bilanci i transferimit, si dhe listat e detajuara të aktiveve dhe detyrimeve janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Shoqëria _____ merr përsipër të heqë dorë nga të gjitha kontratat aktuale për aktivitetet e furnizimit të ujit të pijshëm dhe do të pushojë së ushtruarit këtë aktivitet në vijim.

Shoqëria _____ është e detyruar të lëshojë faturë tatimore për transferimin e pronësisë së aktiveve inventariale dhe pasurive të prekshme. Në këtë faturë nuk do të aplikohet TVSH, në përputhje edhe me parashikimet ligjore për transferimin e aktivitetit.

Vlera totale e asetëve të transferuara do të jetë _____ lekë dhe vlera totale e detyrimit të transferuar do të jetë _____ lekë. Nga ky transaksion, shoqëria SKP-UK i detyrohet shoqërisë _____ vlerën prej _____ lekësh, e cila rezulton si diferencë midis aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në bilancin e transferimit. Kjo diferencë do të njihet si detyrim i ri në bilancin e gjendjes së shoqërisë SKP-UK dhe së bashku me kontribute të tjera aktuale dhe të ardhme të aksionarëve të shoqërisë SKP-UK, do të përdoret për rritjen e kapitalit.

Shoqëria SKP-UK ka detyrimin të shlyejë të gjitha detyrimet e marra përsipër në bilancin e transferimit, si dhe të gjitha detyrimet e ardhme që rrjedhin nga kontratat dhe angazhimet e kaluara apo aktuale të shoqërisë _____.

Shoqëria SKP-UK është person i regjistruar për TVSH-në dhe ka detyrimin të vijojë ushtrimin e rregullt të aktivitetit “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e tyre etj.”.

VLEFISHMËRIA E KONTRATËS

Kontrata është e vlefshme në momentin e nënshkrimit të saj nga palët. Kjo kontratë mund të ndryshohet vetëm me miratimin e të dy palëve dhe me akt noterial.

Kësaj kontrate i bashkëngjiten bilanci i transferimit, si dhe listat analitike të aktiveve dhe detyrimeve, që përfiton shoqëria SKP-UK.

TË PËRGJITHSHME

Palët angazhohen se do të punojnë me vullnet të mirë për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë.

Në rast mosmarrëveshjes, palët do të përpiqen t’i zgjidhin me mirëkuptim; në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë hartohet në tri kopje të barasvlershme dhe nënshkruhet rregullisht nga palët.

SHOQËRIA SKP
ADMINISTRATOR

LIDHJA NR. 4
HARTA TERRITORIALE E SHOQËRIVE SKP QË KRIJOHEN

Propozimi per shoqerite UK qe agregohen

1:1,000,000




TABELA SHPJEGUESE E HARTËS TERRITORIALE

Në tabelën në vijim përcaktohen bashkitë, të cilat janë aksionare në shoqëritë që mbulojnë aktivitetin e furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe që do të përfshihen në subjektin e kompetencave të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkive përkatëse.

Ndarja e shoqërive	
Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a.	
1	Shkodër
2	Fushë-Arrëz
3	Pukë
4	Vau i Dejës
5	Malësi e Madhe
Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a.	
1	Kukës
2	Tropojë
3	Has
Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a.	
1	Lezhë
2	Mirditë
3	Kurbin
Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a.	
1	Dibër
2	Bulqizë
3	Mat
4	Klos
Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a.	
1	Durrës
2	Krujë
3	Kavajë
4	Rrogozhinë
5	Shijak
Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a.	
1	Tiranë
2	Kamzë
3	Vorë
Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a.	
1	Fier
2	Patos
3	Roskovec
4	Mallakastër

	Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sh.a.
1	Lushnjë
2	Divjakë
	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a.
1	Elbasan
2	Librazhd
3	Gramsh sh.a. UK
4	Cërrik
5	Belsh
6	Peqin
	Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a.
1	Berat
2	Kuçovë
3	Dimal
4	Poliçan
5	Skrapar
	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a.
1	Korçë
2	Devoll
3	Maliq
4	Kolonjë
5	Pustec
	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a.
1	Pogradec
2	Përrenjas
	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë sh.a.
1	Gjirokastrë
2	Tepelenë
3	Këlcyrë
4	Përmet
5	Libohovë
6	Dropull
7	Memaliaj
	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a.
1	Vlorë
2	Selenicë
3	Himarë
	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a.
1	Sarandë
2	Finiq
3	Konispol
4	Delvinë